



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Mjësela:	
Unit:	ZK
Jednica:	
Mr. Prof. No.:	422/2019
Br. Prot.:	
Mr. I faqeve:	
No. of pages:	-01-
Dr. stranica:	
Data:	24.12.2019
Prishtine/ku	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

PËR: Dr. Basri Sejdiu, Drejtor i Përgjithshëm SHSKUK
Drejtoret e Klinikave, Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Drejtoret e Spitaleve Rajonale
Drejtoret e Qendrave Kryesore të Mjekësive Familjare
Drejtoret e Qendrave të Mjekësisë Familjare
Drejtoret Komunal të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Drejtoret e Institucioneve Private Shëndetësore
Fakulteti i Mjekësisë

NGA: Dr. Pleurat Sejdiu mr.sci- Kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës

LËNDA: Qarkore informative lidhur me faksimilat me thirrje shkencore/akademike

DATE: 24.12.2019

Të nderuar udhëheqës të institucioneve shëndetësore,

Ju njoftoj se Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës me datë 17 dhjetor 2019 ka mbajtur mbledhjen e rregullt ku janë shqyrtuar propozim amandamentet e akteve juridike të Odës. Në kuadër të këtij takimi janë miratuar propozim amandamentet e Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e mjekëve, ku ndër të tjera është amandamentuar Neni 24 i Rregullorës që parasheh përmbajtjen e faksimilit. Në këtë rast Kuvendi ka aprovuar që në faksimil të shtohen edhe gradat shkencore dhe thirrjet akademike për ata që posedojnë atë.

Andaj, përmes kësaj qarkore informative i njoftoj të gjithë të interesuarit për t'u pajisur me faksimil që përmban thirrje shkencore apo akademike, se afati për paraqitje të kërkesës është deri më datë **1 shkurt 2020**.

Kërkesa inicohet me parashtrimin e formularit të posaçëm për faksimil. Me rastin e inicimit të kërkesës grada shkencore apo thirrja akademike duhet të vërtetohet përmes dorëzimit të aktit juridik përkatës të noterizuar. Poashtu në momentin e parashtrimin të kërkesës ju duhet të dorëzoni faksimilin paraprak të lëshuar nga Oda dhe deri në momentin e punimit të faksimilit të ri ju mund të përdorni faksimil tjetër. PAGESA për faksimilin e ri do të jetë në vlerë prej dhjetë (10) euro (€).

Për cdo informatë shtesë ju lutem i drejtoheni shërbimit profesional të OMK-së.

Me respekt,
Dr. Pleurat Sejdiu mr.sci

